



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



ZKA

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË KAMENICËS PËR VITIN 2024

Prishtinë, qershor 2025

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Kamenicës për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2024, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i pamodifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Kamenicës (KK), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2024.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Kamenicës, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme, Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Komunës së Kamenicës kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

B1 Komuna nuk kishte aplikuar procedurat e prokurimit me rastin e angazhimit të 15 punonjësve me kontrata për shërbime të veçanta;

A1 Komuna në një rast kishte vonesë në pagesën e fatures prej 14 ditë.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetari i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetari i Komunës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Kamenicës.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komunës së Kamenicës është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Kamenicës në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Kamenicës me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Kamenicës.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlydhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet⁴

Gjatë procesit të auditimit, kemi identifikuar disa fusha ku mund të përmirësohet performanca duke përfshirë kontrollin e brendshëm. Testet tona kanë treguar që nevojiten përmirësime në menxhimin e pasurisë, menaxhimin e llogarive të arkëtueshme, personelit, pagesa e faturave brenda 30 ditëve dhe klasifikimi i shpenzimeve, të cilat janë paraqitur me poshtë në forme të gjetjeve dhe rekomandimeve. Gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publike.

Raporti i auditimit ka rezultuar me pesë (5) rekomandime, prej tyre dy (2) janë rekomandime të reja, dy (2) të përsëritura dhe një (1) pjesërisht i përsëritur.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja B1 - Angazhimi i punonjësve me kontrata për shërbime të veçanta pa procedura ligjore

Gjetja Ligji për Zyrarët Publik Nr. 08/L-197, neni 101 përcakton që: “Marrëveshjet për shërbime të veçanta, lidhen sipas legjislacionit përkatës për Prokurimit Publik”. Derisa Rregullorja Nr.001/2022 për Prokurim Publik, Neni 57, paragrafi 57.3, “Shërbimet e veçanta të cilat nuk mund të sigurohen përmes procedurave të rekrutimit janë shërbime profesionale për të cilat Autoriteti Kontraktues ka nevojë por të cilat shërbime nuk mund t’i plotësojë me stafin që ka”. Po ashtu, neni 10.6 i Ligjit të Punës Nr. 03/L-212 thotë se: “Kontrata për një detyre specifike, nuk mund të jetë me e gjatë se 120 dite brenda një (1) viti.

Komuna kishte angazhuar 15 punonjës përmes “Marrëveshjeve për shërbime të veçanta (MShV)”, pa i respektuar procedurat e prokurimit publik. Për këta punonjës nuk ishte aplikuar as procedurë e rekrutimit me kriteret për zgjedhëse, përkundër faktit që të njëjtët ishin angazhuar për punë që kryhen në pozita të rregullta të punës dhe jo për shërbime të veçanta apo detyra specifike, siç kërkohet me ligj.

Kohëzgjatja e kontratave në 3 (tri) raste ishte më gjatë se koha e lejuar ligjore prej 4 (katër) muajsh.

Kjo gjendje ishte për shkak të mungesës së pozitave të aprovuara të vendeve të punës më ligjin për buxhetin e RK-së.

Ndikimi Anashkalimi i procedurave të prokurimit apo procedurave tjera përkatëse për angazhim të stafit ndikon në mos transparencën e procesit duke eliminuar konkurrencën dhe mund të ndikojë në cilësinë e dobët të punës si rezultat i angazhimit të personave jo adekuat për pozita dhe detyra të caktuara.

Rekomandimi B1 Kryetari duhet të sigurojë se për pozita të rregullta të punës angazhohet staf i rregullt përmes procedurave të rekrutimit dhe se për angazhimet për shërbime të veçanta dhe detyra specifike, aplikohen procedurat e prokurimit sipas kërkesave ligjore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A1 - Vonesa në pagesën e faturave

Gjetja Ligji për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësi (LMFPP) nr. 03/L-048 neni 39.1 përcakton se; çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagesë për mallra dhe shërbime e funrizuara dhe/ose punët e realizuara për organizatën buxhetore të paguhen brenda (30) ditëve kalendarike pas pranimit të faturës.

Gjatë testimit të pagesave kemi vërejtur se në një (1) rast në vlerë 11,062€, kishte vonesë në pagesën e faturës për 14 ditë më shumë se afati i lejuar ligjor prej 30 ditësh.

Hyrja në obligime është si shkak i mungeses së mjeteve dhe mos përgjegjësisë së zyrtarëve përgjegjës për realizimin e pagesave brenda afatit kohor ligjor.

Ndikimi

Tejkalimi i afatit ligjor për pagesën e faturave mund ta bëjë komunën subjekt të padive nga operatorët ekonomik, duke shkaktuar shpenzime shtesë gjyqësore/përmbartimore apo obligime për vitin vijues.

Rekomandimi A1

Kryetari duhet të sigurojë që obligimet të planifikohen/buxhetohen dhe paguhen brenda afateve kohore ligjore me qëllim që mos të dëmtohet buxheti i komunës me kosto shtesë të përmbartimit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.2.1 Investimet kapitale

Buxheti final për investimet kapitale ishte 3,001,255€, dhe gjatë vitit 2024 ishin shpenzuar 1,975,996€ apo 66%.

Çështja B2 - Keq klasifikimi i shpenzimeve

Gjetja	<p>Rregulla financiare nr. 01/2013 për shpenzimet publike, neni 18 pika 3 specifikon se shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate, të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ për planin kontabël. Rrjedhimisht, neni 11 i UA 19/2009 për planin kontabël, kërkon nga ZKA dhe ZKF që të sigurojnë që të gjitha transaksionet janë regjistruar në SIMFK sipas strukturës së planit kontabël dhe klasifikimeve të përcaktuara me këtë UA.</p> <p>Përmes pagesave direkte nga Thesari, ishte ekzekutuar pagesa në vlerë 37,029€ për pagat jubilarë dhe shujta, të cilat janë realizuar nga kategoria ekonomike e investimeve kapitale.</p> <p>Klasifikimi joadekuat i shpenzimeve ishte rezultat i mosfunksionimit të mirë të kontrolleve të brendshme në planifikimin e buxhetit.</p>
Ndikimi	Keq klasifikimi i shpenzimeve ndikon në mbivlerësimin/nënvlerësimin e kategorive përkatëse të shpenzimeve duke shkaktuar prezantim jo të drejtë të shpenzimeve në raportin vjetor financiar.
Rekomandimi B2	Kryetari duhet të sigurojë planifikimin dhe realizimin e shpenzimeve në ndarjen adekuate të buxhetit në përputhje me planin kontabël, për të mundësuar raportim të drejtë të tyre në raportin vjetor financiar.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.2 Pasuritë kapitale dhe jokatitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 66,644,668€, pasurive jokatitale është 405,798€, si dhe stoqeve 11,856€.

Çështja C1 - Mospërputhje e njësive të pasurive jo kapitale ndërmjet sistemit të E-pasurisë dhe raportit të inventarizimit

Gjetja Rregullorja nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare, neni 6 paragrafi 1 përcakton se: Çdo organizatë buxhetore duhet të krijojë dhe azhurnoj regjistrin e pasurive jo financiare që i ka në menaxhimin e saj. Regjistri duhet të mbahet ndaras për çdo pasuri dhe në formë të agreguar sipas kategorive të klasifikuara në bazë të planit kontabël.

Nga testimet tona kemi vërejtur se në sistemin e E-pasurisë ishin të regjistruara mbi 7,973 njësi të pasurive jo financiare (nën 1,000€), ndërsa bazuar në raportin e inventarizimit përmbante mbi 18,000 njësi të cilat nuk ishin të regjistruara në E-pasuri. Këto pasuri janë kryesisht inventaret e QMF-ve dhe shkollave.

Për më tepër në raportin e SIMFK të pasurive jo financiare mbi 1,000€, kemi vërejtur regjistrimi të përgjithësuar me përshkrimin e pasurisë pa përcaktim të lokacionit si (asfaltimi i rrugëve lokale, kanalizime në qytet e fshatra, toka etj.), në rastin e tokave nuk na është ofruar një raport i vlerësimit të brendshëm për regjistrimet e 94 njësive në vlerë 43,413,511€.

Kjo ka ndodhur si rezultat i kontrolleve jo efektive në procesin e evidentimit raportimit dhe monitorimit të pasurive jo financiare nën 1,000€ në sistemin e E-pasurisë, ndërsa pasuritë mbi 1,000€ janë regjistruar në mënyrë të përgjithësuar është si pasojë e regjistrimeve totale të pagesave/projekteve e jo në njësi të veçanta të pasurive.

Ndikimi Diferencat mes regjistrit të pasurive jo kapitale në E-pasuri dhe raport të inventarizimit si dhe regjistrimi i përgjithësuar i pasurive kapitale shkakton paqartësi dhe vështirëson menaxhimin dhe kontrollin e pasurive në dispozicion, e po ashtu rrisin rrezikun e humbjes dhe keqpërdorimit të pasurive.

Rekomandimi C1 Kryetari, duhet të sigurohet që do të bëhet harmonizimi i regjistrave të pasurisë jo kapitale në mes të regjistrit të E-pasurisë dhe raportit të inventarizimit, si dhe regjistrimi në detaje i pasurive kapitale për të siguruar se të gjitha pasuritë e komunës janë identifikuar dhe regjistruar në plotëni dhe saktësi në regjistrat përkatës të pasurive komunale.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.3 Të arkëtueshmet

Llogaritë e arkëtueshme në fund të vitit 2024 ishin 2,063,719€. Kjo vlerë përbëhet nga tatimi në pronë 1,539,235€, taksa komunale 358,158€, qiraja nga prona publike 67,011€, taksa komunale për leje ndërtimi 13,105€ dhe shfrytëzimi i pronës publike 86,210€.

Çështja A2 - Menaxhim jo efikas i llogarive të arkëtueshme

Gjetja Sipas nenit 26 të Ligjit për tatimin në pronën e paluajtshme nr.06/L-005, Komuna, Ministria e Financave dhe organet kompetente përmbaruese kanë autoritetin dhe kompetencat për të mbledhur detyrimet tatimore të papaguara që kalojnë shumën e dhjetë (10) Eurove dhe neni 27 Nëse një tatimpagues apo debitor nuk ka paguar plotësisht tatimin dhe gjoben nëse ka të këtillë, ose detyrimet tatimore të papaguara, në perputhje me afatet e përcaktuara, komuna nxjerr njoftimin përfundimtar me shkrim brenda dhjetë (10) ditë pune pas ditës së fundit për pagesë, ku kërkon pagesën e plotë të detyrimeve tatimore të papaguara, jo me vonë se dhjetë (10) ditë kalendarike pas ditës që njoftimi përfundimtar konsiderohet të jetë pranuar nga debitori.

Komuna në PFV e vitit 2024 ka shpalosur llogari të arkëtueshme në vlerë prej 2,063,719€. Kjo vlerë përbëhet nga tatimi në pronë 1,539,235€, taksa komunale 358,158€, qiraja nga prona publike 67,011€, taksa komunale për leje ndërtimi 13,105€ dhe shfrytëzimi i pronës publike 86,210€. Vetëm tatimi në pronë është rritur për 445,120€ në krahasim me vitin 2023.

Kjo kishte ndodhur si shkak i menaxhimit jo efikas të llogarive të arkëtueshme nga ana e komunës për mbledhjen e borxheve tatimore.

Ndikimi Mungesa e mekanizmave dhe efikasitetit për inkasim të borxheve nga debitort mund të shkaktoj probleme në pëëmbushjen e planit të shpenzimeve, ndërsa vjetërsia e tyre zvogëlon gjithnjë e më shumë gjasat që borxhi të inkasohen.

Rekomandimi A2 Kryetari duhet të siguroj që po shqyrtohen në mënyrë aktive të gjitha opsionet e mundshme, duke vendosur politika, rregullore dhe mekanizma tjerë me qëllim të rritjes së efikasitetit në mbledhjen e të arkëtueshmeve. Po ashtu, duhet shqyrtuar të gjitha masat në pajtim me ligjin, ndaj debitorëve të cilët nuk i përmbushin obligimet.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁵	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet
Burimet e fondeve	14,523,816	17,043,427	15,693,066	13,336,901	10,854,784
Grante Qeveritare - Buxheti	13,507,196	15,280,794	14,426,726	11,969,774	9,398,161
Financimi përmes huamarrjes	0	0	0	0	112,956
Të bartura nga viti i kaluar	0	697,876	640,595	548,628	496,897
Të hyrat vetanake	1,016,620	1,016,620	615,551	720,276	768,389
Donacionet vendore	0	45,063	10,194	75,885	21,951
Donacionet e jashtme	0	3,074	0	22,337	56,430

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 2,519,611€. Kjo rritje është rezultat i të hyrave të bartura nga viti i kaluar, donacioneve vendore dhe të jashtme.

Në vitin 2024, janë shpenzuar 15,693,066€ ose 92% e buxhetit final, me një rritje prej rreth 17% krahasuar me vitin 2023.

Se si ishte realizuar buxheti sipas kategorive janë dhënë shpjegimet në tabelën në vijim:

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)


Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	14,523,816	17,043,427	15,693,066	13,336,901	10,854,784
Pagat dhe mëditjet	8,980,426	10,765,928	10,717,383	8,672,076	7,099,227
Mallrat dhe shërbimet	2,274,272	2,260,240	2,000,816	1,770,900	1,447,461
Komunalitë	254,000	254,423	242,275	206,760	211,246
Subvencionet dhe transferet	648,000	761,581	756,596	620,588	578,079
Investimet Kapitale	2,367,119	3,001,255	1,975,996	2,066,576	1,518,770

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar është rritur për 2,519,611€. Kjo rritje është rezultat kryesisht i shtesave në pagat dhe mëditjet dhe investimet kapitale.

Shpenzimet kryesore janë realizuar në këto kategori:

- Buxheti final për pagat dhe mëditjet është rritur për 1,785,502€ krahasuar me buxhetin fillestar. Shpenzimet në këtë kategori janë realizuar pothuajse 100% të buxhetit final.
- Buxheti final për mallrat dhe shërbimet është ulur për 14,032€ krahasuar me buxhetin fillestar. Realizimi i buxhetit për këtë kategori ishte 88% të buxhetit.
- Buxheti final i shpenzimeve komunale ishte pothuajse i njëjtë me atë fillestar, me një dallim prej 423€. ishin realizuar 95% e shpenzimeve tek kjo kategori.
- Buxheti final për subvencionet dhe transferet është rritur për 113,581€ në krahasim me buxhetin fillestar. Shpenzimet në këtë kategori janë realizuar në 99%..
- Buxheti final për investimet kapitale është rritur për 634,136€. Megjithatë, janë realizuar vetëm 66% e buxhetit final.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2024



Të hyrat e realizuara nga komuna në vitin 2024 ishin në vlerë 741,377€. Ato përfshijnë të hyrat nga tatimi në pronë, lejet e ndërtimit, taksa për regjistrimin e automjeteve, qiraja etj. Krahasuar me vitin 2023, të hyrat kanë qenë më të ulëta për 416,090€.

Në shumën totale të pranimeve për vitin 2024, nuk janë të përfshira edhe të hyrat nga gjambat në trafik, gjambat nga Gjykatat dhe Agjencioni i Pyjeve në vlerë prej 233,301€, të cilat grumbullohen nga insitucionet përkatëse dhe i alokohen Komunës për shpenzim.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2024 Pranimet	2023 Pranimet	2022 Pranimet
Totali i të hyrave	1,016,621	1,016,621	741,377	1,157,467	1,088,325
Të hyrat tatimore	593,895	593,895	300,136	595,993	600,370
Të hyrat jo tatimore	422,726	422,726	441,212	559,618	487,863
Të hyrat tjera	0	0	30	1,856	92

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për Pasqyrat Vjetore Financiare (PFV-të) për vitin 2023 të Komuna e Kamenicës (KK) ka identifikuar tetë (8) rekomandime për të përmirësuar efikasitetin dhe proceset. KK ka zhvilluar një plan veprimi për të adresuar këto rekomandime në mënyrë të detajuar. Gjatë periudhës së auditimit për vitin 2024, katër (4) nga rekomandimet janë zbatuar me sukses, një pjesërisht i zbatuar, dy (2) nuk janë zbatuar ende dhe, një nuk është i aplikueshëm më. Për të dhënë një shpjegim më të detajuar të çdo rekomandimi dhe si janë trajtuar ato, ju lutemi referohuni tabelës 4 në vijim.

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4. Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2023	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për opinion	Kryetari duhet të sigurojë përforsimin e komunikimit dhe bashkëpunimit midis sektorit të financave dhe përfaqësuesit ligjor të komunës, me qëllim që informacioni financiar në regjistrin e detyrimeve kontigjente dhe raportimi i tyre të jetë i saktë dhe i plotë në PVF.	Janë ndërmarrë veprimet.	I zbatuar
2.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë arritjen e verifikimit të 20% të pronave të paluajtshme siç kërkohet me ligj.	Janë ndërmarrë veprimet.	I zbatuar
3.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë para çdo aktiviteti të prokurimit që për projektet të cilat mund të kryhen nga autoritetet publike të zbatohet neni 9 paragrafi 4 i LPP-së.	Janë ndërmarrë veprimet.	I zbatuar

4.	Të hyrat	Kryetari duhet të ndërmerr veprimet e nevojshme për të siguruar që baza e të dhënave të tatimit në pronë plotësohet me të gjithë numrat personal të tatimpaguesve, ashtu që të mundësohet verifikimi i të gjitha rasteve potenciale që mund të hasen me përfitim të disahershëm për vendbanim parësor.	Janë ndërmarrë veprimet.	I zbatuar
5.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Kryetari duhet të sigurojë se për pozita të rregullta të punës angazhohet staf i rregullt përmes procedurave të rekrutimit dhe se procedurat e prokurimit për angazhimin e stafit për shërbime të veçanta si dhe kontratat për punë dhe detyra specifike, aplikohen vetëm për pozita specifike dhe të veçanta të cilat nuk mund të mbulohen nga stafi i brendshëm i komunës.	Nuk janë ndërmarrë veprimet.	Nuk ka filluar zbatimin
6.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit (apo të ridestinohen mjetet kur është e nevojshme dhe e mundshme) dhe që pagesa e regjistrimi i shpenzimeve bëhet sipas kodeve ekonomike adekuate.	Nuk janë ndërmarrë veprimet.	Nuk ka filluar zbatimin
7.	Pasuritë	Kryetari, duhet të sigurohet që do të bëhet vlerësimi i pasurive jo financiare për të azhurnuar regjistrin të pasurive për të siguruar se të gjitha pasuritë e komunës janë identifikuar dhe regjistruar në plotëni dhe saktësi në regjistrat përkatës të pasurive komunale.	Rekomandimi i dhënë është zbatuar pjesërisht nga ana e Komunsës.	Pjesërisht i zbatuar
8.	Pasuritë	Kryetari, duhet të sigurohet se procesi i inventarizimit të pasurive do të kryhet sipas kërkesave të Rregullores 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare në organizatat buxhetore, si dhe më pas, të bëhet krahasimi i rezultateve të inventarizimit me gjendjen kontabël të pasurive, duke i sqaruar të gjitha diferencat.	Për shkak të natyrës dhe rëndësisë së kësaj çështje rekomandimi është mbyllur.	Nuk është i aplikueshëm më

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Blerina Krasniqi, Drejtore e Auditimit



Grup i Operatorëve Ekonomik "AlbAudit" SH.P.K. & "ProAudit" SH.P.K.
(Hajdar Hoxhaj, person i autorizuar në emër të grupit)



Shtojca I: Letër konfirmimi



LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2024 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:


- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Kamenicës, për vitin 2024 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- **pajtohem/** nuk pajtohem/ pajtohem pjesërisht/ me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Draft Raportit; si dhe (kjo pikë përshtatet nga entiteti)
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Kryetari i Komunës

Kadri Rahimaj

Data: 30.05.2025,

Nënshkrimi: _____



Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁶ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁷, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁶ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁷ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.